



INFORMATË BAZIKE:

Observeri i Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Serbe dhe Ruse është një raport analitik tremujor për lajmet që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e kanë në shënjestër Kosovën të botuara nga mediat që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi.

PËRKRAHUR NGA:






Londër, Mbretëri e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

KONTAKTI:

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtina, Kosovo




OBSERVERI I DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN MEDIAT RUSE DHE SERBE Korrik – Shtator 2020

Përmbledhje Ekzekutive


Observeri i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Serbe dhe Ruse është një raport tremujor që synon t'i analizojë trendet dezinformuese të lajmeve të botuara në publikimet e përzgjedhura mediale në gjuhët angleze dhe serbe që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi, dhe që e vejnë në shënjestër Kosovën.

Mediat e përzgjedhura që origjinën e kanë në Serbi dhe që janë të njohura për botimin e lajmeve me përmbajtje dezinformuese janë Tanjug, Informeri, Novosti, Kuriri, B92-shi, Politika dhe Naša Borba, ndërsa mediat e përzgjedhura përkatëse që origjinën e kanë në Rusi janë Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider-i, TASS-i, The Moscow Times, Newsfront, Unz, Duran dhe Pravda Report, dhe ky Observer i Dezinformatave për Kosovën po ashtu i analizon edhe dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën të botuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.


Monitorimi i të dhënave tregon se që nga 1 korrik deri më 30 shtator 2020, publikimet mediale që origjinën e kanë në Serbi i kanë botuar 1,348 lajme që drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë ndërlidhen me Kosovën. Tanjugu i ka botuar 155, Informeri 219, Novosti 166, B92-shi 571, Kuriri 52, Politika 117 dhe Naša Borba 69 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë të bëjnë me Kosovën




Trendet dezinformuese të mediave serbe tregojnë se vlera më e lartë në përqindje e raportit lajme/lajme dezinformuese ka qenë në gusht 2020, dhe atë 6.7%, e vijuar nga 2.3% në korrik, dhe nga 1.5% në shtator 2020.



Monitorimi i të dhënave tregon se nga data 1 korrik deri më 30 shtator 2020, publikimet mediale në Rusi kanë botuar 624 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë pasur të bëjnë me Kosovën. Sputniku – Botimi në Serbisht, i ka botuar 520, Sputnik International 17, Russia Today 20, Russia Insider 5, Meduza asnjë, TASS-i 13, The Moscow Times 6, Pravda Report asnjë, Newsfront 21, UNZ-i 6, Durani 8, Kremlin 1 dhe Ministria e Jashtme e Federatës Ruse 7 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë pasur të bëjnë me Kosovën.



Trendet dezinformuese të mediave ruse tregojnë se përqindja më e lartë e raportit lajme/lajme me dezinformata ka qenë në korrik 2020, 11.2%, pasuar nga 7.6% në gusht, ndërsa përqindja më e ulët e këtij raporti ka qenë në shtator 2020, 7.4%.



Dekonstruktimi i lajmeve që origjinën e kanë në Serbi dhe që i përmbajnë dezinformatat më flagrante (17 lajme), të botuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e sipërpërmendura të përzgjedhura, tregon që dezinformimi ka qenë i përqendruar në shkatërrimin e themeleve të legalitetit dhe legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës, përmes:

- Minimit të ligjshmërisë së Kosovës si shtet i pavarur dhe portretizimit të saj si një shtet që rrezikon trashëgiminë serbe dhe ortodokse.
- Mohimit të krimeve të luftës të kryera në Kosovë nga forcat e armatosura serbe gjatë konfliktit 1998-1999.
- Diskreditimit të trajtimit të krimeve të luftës në Kosovë nga drejtësia ndërkombëtare dhe kombëtare.
- Diskreditimi i rolit të Perëndimit dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës në çështjet e sigurisë në Kosovë, dhe,
- Paraqitjes së Beogradit si përfitues i vetëm i Marrëveshjes së Uashingtonit të 4 Shtatorit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Nga ana tjetër, dekonstruktimi i lajmeve që origjinën e kanë pasur në Rusi dhe që i kanë përmbajtur dezinformimet më flagrante (17 lajme), të botuara gjatë kësaj periudhe në mediat e përzgjedhura të sipërpërmendura, tregon që dezinformimi ka qenë i përqendruar në:

- Minimimin e ligjshmërisë së shtetësisë së Kosovës dhe diskreditimin e institucioneve të saj.
- Portretizimin e Kosovës si një shtet që shkel të drejtat e njeriut dhe shtyp Komunitetin Serb dhe komunitetet e tjera jo-shumicë.
- Vërjen në pikëpyetje dhe ndryshimin e historisë mbi luftën në ish Jugosllavi duke akuzuar SHBA-në dhe NATO-n për krimet e luftës, duke mohuar krimet e luftës të Serbisë, si dhe,
- Akuzimin e Kosovës për shkelje dhe sabotim të institucioneve të arritura në Bruksel dhe Uashington.


Prandaj, mund të përfundohet që, nga këndvështrimi i përqendrimit të tyre, lajmet me përmbajtje dezinformuese që kanë të bëjnë me Kosovën, që gjatë kësaj periudhe janë botuar nga mediat që origjinën e kanë në Serbi dhe në Rusi, ishin shumë të ngjashme sa i përket përmbajtjes dhe qëllimit të tyre.

Analizat vijuese do të paraqesin të dhënat statistikore mujore për raportet lajme/lajme me dezinformata për botimet e përzgjedhura mediale me origjinë në Serbi dhe Rusi, dhe këto do të ofrojnë po ashtu edhe analiza të shkurtëra, për përqendrimet dhe synimet e dezinformatave të botuara, bazuar në analizat e dezinformimeve të botimeve të muajve korrik, gusht dhe shtator të vitit 2020 të Lajmëtarëve të Dezinformatave për Kosovën për Mediat Serbe dhe ato Ruse.

Lajmet dhe dezinformatat

Korrik 2020

Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga 1 deri më 30 korrik të vitit 2020, Tanjugu i ka botuar 46, Informeri 45, Novosti 62, B92-shi 220, Kuriri 21, Politika 38, dhe Naša Borba 6 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kishin të bënin me Kosovën. 10 nga 438 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kishin përmbajtje dezinformuese.




Dekonstruktimi i lajmeve që i përmbanin dezinformimet më flagrante (4 lajme) të botuara gjatë korrikut 2020 tregon se dezinformimi ka qenë i përqendruar në mohimin e krimeve serbe të luftës dhe të viktimave dhe personave të zhdukur në Kosovë, në denigrimin e ndërhyrjes së ambasadori William Walker, denigrimin e trajtimit të krimeve të luftës në Kosovë nga drejtësia vendore dhe ndërkombëtare, dhe përçmimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gjermanisë, nën pretendimin se ata kanë bërë një marrëveshje të fshehtë për blerjen e tankeve të tipit 'Leopard II'¹.

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave në mediat ruse tregon se nga 1 deri më 30 Prill, 2020, Sputnik Serbia ka botuar 164, Sputnik International 3, Russia Today 6, Russia Insider 3, Meduza

¹ Lajmëruesi i dezinformatave për Kosovën, Media Serbe Media, korrik 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - July 2020 704688.pdf>

asnjë, TASS 5, Koha e Moskës 1, Raporti Pravda asnjë, Newsfront 6, UNZ asnjë, Duran 4, Kremlin asnjë dhe Ministria e Jashtme Ruse 4 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kishin të bënin me Kosovën. 22 nga 196 prej këtyre lajmeve lidhur me Kosovën të botuara nga këto media, kishin përmbajtje dezinformuese.




Dekonstruktimi i lajmeve dezinformuese të publikuara në korrik 2020 nga mediat e përzgjedhur ruse dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Rusisë në lidhje me Kosovën, tregon se ata ishin përqendruar në minimin e ligjshmërisë së shtetësisë së Kosovës, duke diskredituar institucionet e Kosovës dhe udhëheqjen e saj, duke projektuar Kosovën si një shtet të dështuar që nuk respekton të drejtat e njeriut dhe diskriminon serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera jo-shumicë, duke errësuar të kaluarën duke mohuar *de facto* krimet dhe mizoritë e Serbisë në Kosovë gjatë viteve 90, dhe duke portretizuar serbët si viktimat të Luftës së Kosovës².

² Lajmëruesi i dezinformatave për Kosovën, Mediat Ruse Korrik 2020, http://www.kipred.org/repository/docs/D_-_Alert_-_Russian_Media_-_July_2020_402139.pdf

Lajmet dhe Dezinformatat Gusht 2020


Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga data 1 deri më 31 gusht 2020, Tanjugu i ka botuar 37, Informer 64, Novosti 64, B92-shi 149, Kuriri 12, Politika 43 dhe Naša Borba 20 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. 26 nga 389 lajme të botuara nga këto publikime mediale kanë pasur përmbajtje dezinformuese.



Dekonstruktimi i lajmeve që i kanë përmbajtur dezinformimet më flagrante (5 lajme) të botuara në gusht 2020 tregon se dezinformatat kanë qenë të përqendruara në diskreditimin e legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës duke iu referuar Kosovës si "kuazi-shtet" dhe "shtet fals", duke e portretizuar Kosovën si një shtet që rrezikon trashëgiminë serbe shpirtërore dhe atë të krishterë, duke paraqitur disa pretendime të rreme për të diskredituar UÇK-në dhe NATO-n, duke portretizuar në mënyrë të rreme luftën çlirimtare të UÇK-së si një nga krimet e luftës kundër njerëzimit, duke mohuar krimet e luftës të kryera nga Serbia gjatë luftës në Kosovë dhe bërja e pretendimeve të rreme se dërgesat amerikane të armëve dhe pajisjeve ushtarake tek autoritetet e Kosovës është pjesë e përgatitjeve për një konflikt të hapur me Serbinë³.

³ Lajmëruesi i dezinformatave për Kosovën, Mediat serbe, gusht 2020, http://www.kipred.org/repository/docs/D_-_Alert_Serbian_Media_-_Gusht_2020_AD_620224.pdf

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave për mediat ruse tregon se nga 1 deri më 31 gusht 2020, Sputnik Serbia i ka botuar 139, Sputnik International asnjë, Russia Today 5, Russia Insider asnjë, Meduza asnjë, TASS-i 1, The Moscow Times 1, Pravda Report asnjë, Newsfront 6, UNZ-i 3, Durani 1, Kremli asnjë, dhe Ministria e Jashtme Ruse 1 lajm, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. 12 nga 157 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kanë pasur përmbajtje dezinformuese.




Dezinformimi i publikuar nga mediat ruse u përqendrua në minimin e ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës, duke bërë paralele të papërshtatshme midis Kosovës dhe Republikës Srpska, duke diskredituar praninë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë duke akuzuar Perëndimin për aneksimin e një pjese të territorit serb dhe duke pretenduar në mënyrë të rreme se ka ende 18,000 prona të uzurpuara të qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë.⁴

⁴ Lajmëruesi i dezinformatave për Kosovën, Mediat ruse gusht 2020, http://www.kipred.org/repository/docs/D_-_Alert_Serbian_Media_-_Gusht_2020_AD_620224.pdf

Lajmet dhe Dezinformatat

Shtator 2020


Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga 1 deri më 30 shtator 2020, Tanjugu i ka botuar 72, Informeri 110, Novosti 40, B-92-shi 202, Kuriri 19, Politika 36, dhe Naša Borba 42 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë pasur të bëjnë me Kosovën. 19 nga 573 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kanë pasur përmbajtje dezinformuese.



Dekonstruktimi i lajmeve që i kanë përmbajtur dezinformimet më flagrante (5 lajme) të botuara në shtator 2020 tregon se dezinformatat kanë qenë të përqendruara në diskreditimin e legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës, duke e paraqitur Beogradin si përfituesin e vetëm të Marrëveshjes së Uashingtonit midis Kosovës dhe Serbisë, duke diskredituar liderët e Kosovës, dhe portretizuar Kosovën si një shtet që rrezikon pakicën serbe dhe po planifikon të dëbojë serbët e mbetur që jetojnë në Kosovë⁵.

⁵ Lajmëruesi i dezinformatave për Kosovën, Mediat serbe, shtator 2020, [http://www.kipred.org/repository/docs/Serbian_Media - Alert_September_fin.docx_902025.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Serbian_Media_-_Alert_September_fin.docx_902025.pdf)

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave në mediat ruse tregon se nga 1 deri më 30 shtator 2020, Sputnik Serbia ka botuar 217, Sputnik International 14, Russia Today 9, Russia Insider 2, Meduza asnjë, TASS 7, Moscow Time 4, Pravda Report asnjë, Newsfront 9, UNZ 3, Duran 3, Kremlin 1 dhe Ministria e Punëve të Jashtme Ruse 2 lajme, të lidhura drejtpërdrejt ose të tërthortë me Kosovën. 20 nga 271 lajmet e publikuara nga këto media kishin përmbajtje dezinformuese.



Dezinformatat e publikuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e përzgjedhura ruse në raport me Kosovën, kanë qenë të përqendruara në minimin e shtetësisë së Kosovës, diskreditimin e besueshmërisë së politikës amerikane, mohimin e krimeve të luftës të kryera nga Serbia në Kosovë, duke akuzuar SHBA-në dhe NATO-n për krime lufte kundër popullsisë serbe, duke ekzagjeruar numrin e viktimave serbe, duke akuzuar institucionet e Kosovës për shkelje dhe sabotim të marrëveshjeve të arritura në Uashington dhe Bruksel.⁶

⁶ Lajmëruesi i dezinformatave për Kosovën, Mediat ruse shtator 2020, http://www.kipred.org/repository/docs/Russian_Media_-_Alter_September_fin_871089.pdf